

**KOMBET E  
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen  
Penale të Personave Përgjegjës për  
Shkelje të Rënda të së Drejtës  
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera  
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej  
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-AR65.1

Data: 16 dhjetor 2010

Originali: anglisht

**NË DHOMËN E APELIT**

**Para:** Gjykatësit Patrick Robinson, Kryegjykatës  
Gjykatësit Fausto Pocar  
Gjykatësit Liu Daqun  
Gjykatësit Andrésia Vaz  
Gjykatësit Theodor Meron

**Sekretari:** Z. John Hocking

**Vendim:** 16 dhjetor 2010

**PROKURORI**

**kundër**

**RAMUSH HARADINAJT  
IDRIZ BALAJT  
LAHI BRAHIMAJT**

**PUBLIK**

**VENDIM MBI APELIN E PROKURORISË KUNDËR VENDIMIT TË DHOMËS  
GJYQËSORE MBI MOCIONIN E RAMUSH HARADINAJT PËR LIRIM TË  
PËRKOHSHËM**

**Zyrës së Prokurorit:**

Z. Paul Rogers

**Avokatëve të Mbrojtjes:**

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn  
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn  
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

1. Dhoma e Apelit e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali”) ka marrë “Apel i Prokurorisë Kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm”, dorëzuar nga Zyra e Prokurorit (“Prokuroria”) më 9 dhjetor 2010 (“Apeli”), kundër “Vendim mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm” lëshuar prej Dhomës Gjyqësore II (“Dhoma Gjyqësore”) më 8 dhjetor 2010 që miratoi lirim të përkohshëm për Ramush Haradinajn (“Haradinaj”).<sup>1</sup> Haradinaj e dorëzoi përgjigjen më 13 dhjetor 2010.<sup>2</sup>

## **I. HISTORIA PROCEDURALE**

2. Më 19 korrik 2010, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimit të Gjykatësit Robinson, shfuqizoi vendimin e Dhomës Gjyqësore për dhënien e pafajësisë Haradinajt, Idriz Balajt (“Balaj”), dhe Lahi Brahimaajt (“Brahimaj”) për disa pika të Aktakuzës dhe urdhëroi rigjykim për këto pika<sup>3</sup>. Dhoma e Apelit urdhëroi mbajtjen në paraburgim të Haradinajt, Balajt dhe Brahimaajt dhe urdhëroi Komandantin e Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara që t’i mbante të paraburgosur deri në një urdhër tjetër<sup>4</sup>.

3. Më 10 shtator 2010, Dhoma Gjyqësore rrëzoi një mocion të Haradinajt për lirim të përkohshëm.<sup>5</sup> Më 8 dhjetor 2010, në Vendimin e vet të Kundërshtuar, Dhoma Gjyqësore miratoi lirimin e përkohshëm të Haradinajt. [Dhoma Gjyqësore] u bind se Haradinaj do të paraqitej në gjykim<sup>6</sup> dhe se në qoftë se lirohej, Haradinaj nuk do të përbënte rrezik ndaj ndonjë viktime, dëshmitari apo individit tjetër.<sup>7</sup> Pas shqyrtimit të faktorëve përkatës, Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk do ushtronte kompetencën për refuzimin e lirim të përkohshëm

<sup>1</sup> *Prokurori k .Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 8 dhjetor 2010 (“Vendim i Kundërshtuar”).

<sup>2</sup> Përgjigje në Emër të Ramush Haradinajt në lidhje me Apelin e Prokurorisë ndaj Vendimit të Dhomës Gjyqësore mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 13 dhjetor 2010 (“Përgjigje”). Për shkak të urgjencës së çështjes dhe duke marrë parasysh se Prokuroria nuk do të dëmtohet prej rezultatit të këtij vendimi, Dhoma e Apelit gjykon se është në interes të drejtësisë që ky vendim të shpallet para mbarimit të afatit për dorëzimin e një kundërpërgjigjeje në lidhje me Përgjigjen.

<sup>3</sup> *Prokurori k .Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-A, Aktgjykim, 19 korrik 2010 (“Aktgjykimi i Apelit Haradinaj dhe të tjerë”), para 377.

<sup>4</sup> *Po aty*.

<sup>5</sup> *Prokurori k .Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 10 shtator 2010 (“Vendim i 10 shtatorit 2010”), f. 9.

<sup>6</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para 18.

<sup>7</sup> *Po aty.*, para 19.

të kërkuar.<sup>8</sup> Gjithashtu Dhoma Gjyqësore miratoi kërkesën e Prokurorisë për pezullimin e zbatimit të Vendimit të Kundërshtuar derisa të merrej vendimi në lidhje me apelin.<sup>9</sup>

## II. STANDARDI I RISHIKIMIT

4. Dhoma e Apelit rikujton se apeli i ndërkohshëm nuk është rishikim *de novo* i vendimit të Dhomës Gjyqësore.<sup>10</sup> Dhoma e Apelit më parë ka konkluduar se vendimet për lirim të përkohshëm prej Dhomave Gjyqësore në bazë të Rregullës 65 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”) janë brenda kompetencës gjykuese të tyre.<sup>11</sup> Rrjedhimisht, hulumtimi përkatës nuk ka të bëjë me faktin nëse Dhoma e Apelit pajtohet me vendimin e marrë mbi bazën e kompetencës gjykuese të [Dhomës Gjyqësore], por nëse Dhoma Gjyqësore ka ushtruar si duhet kompetencën e saj në marrjen e këtij vendimi.<sup>12</sup>

5. Për rrëzimin e një vendimi për lirim të përkohshëm marrë mbi bazën e kompetencës gjykuese, pala përkatëse duhet të provojë se Dhoma Gjyqësore ka bërë një gabim të dukshëm.<sup>13</sup> Dhoma e Apelit prapëson një vendim të Dhomës Gjyqësore për lirim të përkohshëm vetëm kur konkludon se (a) bazohet në interpretim të pasaktë të ligjit në fuqi; (b) bazohet në konkluzion qartazi të pasaktë faktesh; ose (c) është i padrejtë dhe i paarsyeshëm në atë masë sa përbën shpërdorim të kompetencës prej Dhomës Gjyqësore.<sup>14</sup> Gjithashtu Dhoma e Apelit do të shqyrtojë nëse Dhoma Gjyqësore u ka kushtuar rëndësi faktorëve të

<sup>8</sup> *Po aty.*, para 26.

<sup>9</sup> *Po aty.*, f. 10.

<sup>10</sup> *Shih p.sh. Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR65.11, Vendim mbi Apelin e Pralakit Kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 2 dhjetorit 2008 mbi Lirimin e Përkohshëm, 17 dhjetor 2008, para 4 (“Vendimi Pralak”) (citon *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-AR65.2, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Lahi Brahimaajt Kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore që Refuzoi Lirimin e tij të Përkohshëm, 9 mars 2006 (“Vendimi Brahimaaj”), para 5; *Prokurori k. Stanishiqit*, Lënda Nr. IT-04-79-AR65.1, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Prokurorisë Kundër Lirimit të Përkohshëm të Miqo Stanishiqit, 17 tetor 2005 (“Vendimi Stanishiq”), para 6; *Prokurori k. Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, Lënda Nr. IT-04-82-AR65.2, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Lube Boshkoskit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, 28 shtator 2005, para 5).

<sup>11</sup> *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-T, Vendim mbi Mocionin e Të Akuzuarit Pralak për Lirim të Përkohshëm 25 korrik 2008, (publik me shtojcë konfidenciale), para 6. Ky vendim fillimisht u dorëzua në frëngjisht, më 17 korrik 2008

<sup>12</sup> *Shih p.sh. Vendimi Pralak*, para 4; *Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-AR65.2, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm Kundër Refuzimit të Lirimit të Përkohshëm Gjatë Pushimeve Dimërore, 14 dhjetor 2006, para 3; *Prokurori k. Popoviqit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-88-AR65.2, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Mbrojtjes Kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore që Refuzoi Lirimin e Përkohshëm të Lubomir Borovçaninit, 30 qershor 2006, para 5.

<sup>13</sup> Vendimi *Pralak*, para. 5 (pa citimin e brendshëm).

<sup>14</sup> *Po aty.*

jashtëm ose pa lidhje, apo nuk u ka kushtuar rëndësi ose rëndësi të mjaftueshme faktorëve përkatës në marrjen e vendimit.<sup>15</sup>

### III. LIGJI PËRKATËS

6. Në paragrafin (A) të Rregullës 65(A) të Rregullores parashtrohet se pas paraburgimit, i akuzuari nuk mund të lirohet veçse me urdhër të një Dhome. Sipas paragrafit (B) të Rregullës 65 të Rregullores, një Dhomë mund të urdhërojë lirim të përkohshëm vetëm në qoftë se bindet se po të lirohet i akuzuari do të paraqitet në gjyq dhe nuk do të përbëjë rrezik për asnjë viktimë, dëshmitar, ose person tjetër dhe pasi u jep mundësinë për të shprehur mendimin vendit pritës dhe shtetit në të cilin i akuzuari kërkon të lirohet.<sup>16</sup>

7. Për të përcaktuar nëse janë përmbushur kushtet e paragrafit (B) të Rregullës 65 të Rregullores, Dhoma Gjyqësore duhet të shqyrtojë të gjithë faktorët përkatës që normalisht një Dhomë e arsyeshme Gjyqësore merr parasysh para vendimit,<sup>17</sup> dhe duhet të ofrojë një arsyetim në lidhje me këta faktorë përkatës.<sup>18</sup> Natyra e këtyre faktorëve përkatës dhe rëndësia që u kushtohet varen prej rrethanave konkrete të çështjes.<sup>19</sup> Arsyeja është sepse vendimet mbi mocionet për lirim të përkohshëm janë të ngjeshura në fakte dhe çështjet gjykohen veçazi bazuar në rrethanat konkrete të një të akuzuari.<sup>20</sup> Dhomës Gjyqësore i kërkohet jo vetëm të vlerësojë këto rrethana ekzistuese në kohën kur merr vendimin mbi lirimin e përkohshëm, por gjithashtu për aq sa mund të parashikohet, edhe rrethanat e pritshme të kthimit të të akuzuarit në Tribunal.<sup>21</sup> Në qoftë se Dhoma Gjyqësore bindet se janë përmbushur kushtet e paragrafit (B) të Rregullës 65, ajo gëzon kompetencë gjykuese për miratimin ose mosmiratimin e lirimin të përkohshëm të një të akuzuari.

<sup>15</sup> *Prokurori k. Popoviqit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr: IT-05-88-AR65.7, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Vujadin Popoviqit Kundër Vendimit mbi Mocionin e Popoviqit për Lirim të Përkohshëm, 1 korrik 2008, para 6.

<sup>16</sup> Vendimi *Pralak*, para 6; Vendimi *Brahimaj*, para 6.

<sup>17</sup> Vendimi *Pralak*, para 7; Vendimi *Brahimaj*, para 10.

<sup>18</sup> Vendimi *Pralak*, para 7; shih edhe Vendimi *Brahimaj*, para 10.

<sup>19</sup> Vendimi *Pralak*, para 7; Vendimi *Stanishiq*, para 8.

<sup>20</sup> *Prokurori k. Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, Lënda Nr: IT-04-82-AR65.1, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Johan Tarçulovskit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, 4 tetor 2005, para 7.

<sup>21</sup> Vendimi *Pralak*, para 7; Vendimi *Stanishiq*, para 8.

#### IV. PARASHTRIME

8. Prokuroria argumenton se Vendimi i Kundërshtuar është i paarsyeshëm në atë masë sa përbën shpërdorim kompetence prej Dhomës Gjyqësore<sup>22</sup> dhe pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se lirimi i Haradinajt nuk do të përbënte rrezik ndaj dëshmitarëve.<sup>23</sup> Prokuroria thekson se në Vendimin e 10 shtatorit 2010 që refuzoi lirim të përkohshëm për Haradinajn, Dhoma Gjyqësore konstatoi se frikësimi i dëshmitarëve ishte mbizotërues në Kosovë dhe me gjasë, me ndikim ndaj dëshmitarëve jashtë Kosovës.<sup>24</sup> Gjithashtu Prokuroria citon deklaratën e Dhomës Gjyqësore në Vendimin e Kundërshtuar se problemi i frikësimit të dëshmitarëve nuk është përmirësuar që prej refuzimit të lirit të përkohshëm për Haradinajn në shtator 2010.<sup>25</sup> Bazuar në sa më sipër, Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se afati dhe kohëzgjatja e lirit nuk do të rrezikonin ta komprometonin thelbësisht procesin.<sup>26</sup> Si rezultat, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore shpërdori kompetencën e saj kur miratoi lirim të përkohshëm për Haradinajn dhe kërkon që Dhoma e Apelit ta prapësojë Vendimin e Kundërshtuar dhe të rrëzojë kërkesën e Haradinajt për lirim të përkohshëm.<sup>27</sup>

9. Në përgjigje Haradinaj argumenton se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi të gjithë faktorët përkatës në ushtrimin e kompetencës së saj për miratimin e lirit të tij të përkohshëm.<sup>28</sup> Konkretisht, Haradinaj parashtron se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi çdo faktor përkatës, ndër të cilët edhe kohëzgjatjen e lirit të përkohshëm, kohën e lirit, kohëzgjatjen e mbajtjes së tij në paraburgim, rrethanat e tij personale, fazën e tanishme paragjyqësore dhe datën e mundshme të fillimit të gjykit.<sup>29</sup> Së fundi Haradinaj parashtron se Prokuroria nuk ka provuar gabim të dukshëm që do të përlligjte ndërhyrjen e Dhomës së Apelit dhe se apeli duhet hedhur poshtë.<sup>30</sup>

<sup>22</sup> Apel, para 1, 9.

<sup>23</sup> *Po aty.*, para 2-3, 5-6.

<sup>24</sup> *Po aty.*, referencë në Vendimin e 10 shtatorit 2010, para 35, 39.

<sup>25</sup> *Po aty.*, referencë në Vendimin e Kundërshtuar, para 35, 39.

<sup>26</sup> *Po aty.*, para 6. Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk i kushtoi rëndësinë e mjaftueshme kontekstit të spikatur politik, zgjedhjet kombëtare, gjatë të cilave do të lirohej Haradinaj. *Po aty.*, para 7.

<sup>27</sup> *Po aty.*, para 9.

<sup>28</sup> Përgjigje, para 4.

<sup>29</sup> *Po aty.*, para 8-9, 12-15. Gjithashtu Haradinaj pretendon se argumentet e parashtruara prej Prokurorisë në lidhje me zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 në Kosovë janë “pa vend” *Po aty.*, para 16.

<sup>30</sup> Përgjigje, para 17.

## V. DISKUTIM

10. Ne Vendimin e Kundërshtuar, Dhoma Gjyqësore gjykoi se ishin përmbushur dy kushtet e paragrafit (B) të Rregullës 65.<sup>31</sup> Më tej Dhoma Gjyqësore mori në shqyrtim një numër faktorësh për të përcaktuar nëse duhej ta ushtronte kompetencën për mosmiratimin e lirimit të përkohshëm.<sup>32</sup> Konkretisht u konstatua se “nuk ka arsye të mendohet se që prej vendimit të shtatorit 2010, atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve është përmirësuar”.<sup>33</sup> [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu pranoi se frikësimi i dëshmitarëve mbetet mbizotërues në Kosovë dhe se kishte prova se që prej urdhërimit të rigjyimit, dëshmitarët ishin ndjerë të kërcënuar.<sup>34</sup> Për më tepër, Dhoma Gjyqësore gjykoi se lirimi i përkohshëm i Haradinajt do të kontribuonte në atmosferën kërcënuese ndaj dëshmitarëve dhe mund të inkurajonte përkrahësit e tij në kryerjen e akteve të frikësimit.<sup>35</sup> Pavarësisht këtyre konstatimeve, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “pasoja e mundshme e lirimit të përkohshëm të kërkuar të të Akuzuarit në lidhje me komprometimin e procesit, nuk do të ishte thelbësore”.<sup>36</sup>

11. Dhoma e Apelit gjykon se ky konkluzion përbën shpërdorim kompetence prej Dhomës Gjyqësore. Pas përmendjes së faktorëve që anojnë fuqishëm kundër miratimit të lirimit të përkohshëm, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore kishte detyrim ta ushtronte kompetencën në mënyrë të përshtatshme. Dhoma e Apelit thekson se në mbështetje të miratimit të lirimit të përkohshëm Dhoma Gjyqësore mori parasysh kohëzgjatjen relativisht të paktë të lirimit të kërkuar të përkohshëm, paqartësinë në lidhje me datën e fillimit të gjykit dhe kohëzgjatjen e mbajtjes në paraburgim të Haradinajt.<sup>37</sup> Mirëpo në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje, Dhoma e Apelit gjykon se këta faktorë nuk mjaftojnë për eliminimin e shqetësimeve të pranura prej Dhomës Gjyqësore, përse i përket gjasës së frikësimit të dëshmitarëve apo rrezikut të brendaqenësishëm të komprometimit të procesit. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit mendon se vendimi i Dhomës Gjyqësore për miratimin e lirimit të përkohshëm të Haradinajt ishte i paarsyeshëm në atë masë sa përbën shpërdorim kompetence.

<sup>31</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para 18-19.

<sup>32</sup> *Po aty.*, para 20-25.

<sup>33</sup> *Po aty.*, para 21.

<sup>34</sup> *Po aty.*

<sup>35</sup> *Po aty.*

<sup>36</sup> *Po aty.*, para 22.

<sup>37</sup> *Po aty.*, para 22, 25

## **VI. VENDIM**

Për arsytet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit **MIRATON** Apelin dhe **ANULON** Vendimin e Kundërshtuar

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në original/  
Gjykatës Patrick Robinson  
Kryegjykatës

Sot, më datën 16 dhjetor 2010.  
Në Hagë  
Holandë

**[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]**